



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:211215
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05426547

AC.nr.8437/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin, Delushe Halimi, e me bashkëpunëtoren profesionale Arjeta Sylja, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, B. M. nga fshati N., Komuna F., të cilin me autorizim e përfaqëson avokat B. Q., nga F., kundër, debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, për pagesën e kompensimit për shpronësim, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.284/21, të datë 17.11.2022, jashtë seance me datë 08.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktures, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.284/21, të datës 17.11.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.284/21, të datë 17.11.2022, ka vendosur: Refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.697/21, i datës 30.08.2021, i lëshuar nga përmbaruesi privat B. T. nga F. dhe mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.697/21, i datës 30.08.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar pala debitore, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të miratohet ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi PPP.nr.284/21 i datës 17.11.2022 dhe hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzoj si të pabazuar ankesën e debitorit dhe të vërtetojë aktvendimin e Gjykatës Themelore Ferizaj, PPP.nr. 284/21 të datës 17.11.2022, si dhe përveç shpenzimeve të procedurës përbarimore njohura deri më tani, kreditorit, debitori t'ia kompensoj në emër të shpenzimeve të procedurës përbarimore, edhe shumën prej 156.00 euro, në emër të përpilimit të kësaj përgjigje në ankesë sipas tarifës së OAK-së

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore dhe vëren se:

Ankesa e debitorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, me datë 30.08.2021, ka paraqitur propozim për përbarim kundër debitorit, në bazë të dokumentit përbarimor, vendimit përfundimtar Nr... të datës ... dhe kopja e akt vlerësimit të datës

Përbaruesi Privat, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit, me Urdhrin Përbarimor P.nr.697/21, të datës 30.08.2021, ka lejuar përbarimin.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përbarimit të përbaruesit privat, dhe e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin e përbaruesit privat.

Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar prapësimin e përfaqësuesit të debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përbarimor, me arsyetim ndër të tjera se: Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përbarimit dhe pretendimet në prapësim të përfaqësuesit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përbarim P.nr.697/21, i datës 30.08.2021, i lëshuar nga përbaruesi privat, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore ngase përbaruesi privat e ka lejuar përbarimin, në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.2, dhe nenit 24, par 3, të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të parashtruara në ankesë, se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, neni 182.1 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin e prapësimit e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Gjykata e shkallës së dytë pas shqyrtimit të ankesës, aktvendimit të ankimuar e në raport me provat nga shkresat e lëndës, gjeti se ankesa e debitorit është e pa bazuar për faktin se, me vendimin përfundimtar të debitorit Nr.17/107 të datës 18.06.2019, me të cilin ishte aprovuar shpronësimi përkatës, veç tjerash, me pikën 2 të tij, është paraparë se “Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme (dt. 08.06.2018) dhe tabelat e bashkangjitura këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit....”. Gjithashtu, në pikën 7 të vendimit të sipër cekur, është paraparë se " vendimi hyn në fuqi në momenti e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë". Ndërsa në pikën 5 e ka përfshi edhe obligimin e pagesës për shpronësimet e realizuara. Kur jemi këtu, në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar se, me dispozitën e nenit 22 par.1, nënp.1.2, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, veç tjerash, shprehimisht parashihet se dokumente përmbaruese janë edhe “vendimi përmbarues i dhënë në procedurën administrative dhe aktpajtimi (mëtej: ujdia)”, përkatësisht, me dispozitën e nenit 27 par. 1, përcaktohet shprehimisht se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, sikundër edhe është rasti konkret, nga se vendimi dhe akti i vlerësimit të sipër cekur, përmbajnë, kumulativisht, të gjitha elementet që parasheh dispozita ligjore e sipër cituar, ndaj, nga këtu, vendimi përfundimtar i institucionit të sipër përmendur, konsiderohet, konform nenit 22 dhe 27 të LPP-së, dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të përsëritura të cilat drejtë i ka arsyetuar edhe gjykata e shkallës së parë, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është përcaktuar se “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, Gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.8437/2022, datë 08.03.2024

Gjyqtarja
Delushe Halimi